



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

KUVENDI I ODËS STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS (OSK-së) në mbështetje të Nenit 19, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.12 dhe 1.13 të Lgjit 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor; Nenit 20, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.12, 1.13 dhe 1.14 të Statutit të Odës së Stomatologëve të Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me 21 dhjetor 2019 nxjerrë këtë:

V E N D I M

**PËR CAKTIMIN E LARTËSISË SË TAKSAVE ADMINISTRATIVE NË
OSK**

I. Taksat administrative për anëtarësim

Të gjithë anëtarët e Odës për rrethanat e mëposhtme janë të obliguar të paguajnë taksat administrative si në vijim:

1. Për regjistrim në regjistrin e anëtarëve të Odës, në shumën prej 5.00 €
2. Për regjistrim të anëtarësisë vjetore prej 50.00 € për të gjithë stomatologët e vendit.
3. Për regjistrim të anëtarësisë vjetore prej 100.00 € për stomatologët e huaj që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Kosovës;

4. Për ri regjistrimin e dytë në regjistrin e anëtarësisë së Odës, në rastin kur është larguar nga regjistri i anëtarësisë pas shqiptimit të masës disiplinore, në shumën prej 100.00 €.
5. Për aplikim për ndërrim të kartelës për shkak të ndërrimit të statusit profesional apo për shkak të humbjes, dëmtimit të kartelës së anëtarësisë së Odës në shumën prej 5.00 €.

II. Taksat administrative për licencim dhe rilicencim

1. Taksa administrative për valorizimin e pikëve akredituese në shumë prej 5.00 €.
2. Taksa administrative për dhënie të licencës së punës në shumë prej 100.00 € për kohëzgjatje prej 5 (pesë) viteve;
3. Për ekzemplar in e dublikimit të licencës së punës në shumën prej 15.00 €;
4. Për lëshim të faksimilit në shumën prej 20.00 €.
5. Për nënshtrim të provimit vlerësues të njohurive/shkathhtësive me qëllim të grumbullimit të pikëve akredituese të mjaftueshme për edukim të vazhdueshëm profesional në shumën prej 200 €.

III. Taksa administrative për organizim të eventeve të ndryshme

1. Taksa administrative për aplikim të organizimit të eventeve të ndryshme profesionale në shumë prej 200.00 €.
2. Për çdo certifikatë të lëshuar 10 % e vlerës së kuotizimit të eventit, në llogari të Odës.

IV. Taksat administrative në procedurën e mbikëqyrjes etike

1. Për lëshimin e certifikatës për të kaluarën etike për përdorim brenda vendit në shumën prej 5.00 €.
2. Për lëshimin e certifikatës për të kaluarën etike për përdorim jashtë vendit në shumën prej 30.00 €.

3. Taksat sipas pikës 1 dhe 2 janë të vlefshme në afat kohor prej 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit të certifikatës (vërtetimit).

V. Taksat e përgjithshme administrative

Për nevojat personale të anëtarëve të OSK-së lidhur me lëshimin e dokumenteve të ndryshme, përcaktohen taksat administrative si në vijim:

1. Për dokumente dhe certifikatat e lëshuara për përdorim brenda Republikës së Kosovës në shumë prej 5 €;
2. Taksa administrative për dokumente dhe certifikata të lëshuara për përdorim jashtë territorit të Republikës së Kosovës në shumë prej 25.00 €.

VI. Taksat administrative për dhënien e lejes për hulumtime bio-mjekësore

- I. Aplikuesit për dhënien e lejitmit për hulumtime bio-mjekësore, persona fizik apo juridik, do të jenë të obliguar që të paguajnë taksën administrative si në vijim:
 1. Për anëtarë të OSK-së, qytetar të Republikës së Kosovës në shumën prej 100.00€;
 2. Për jo-anëtarë të OSK-së, qytetarë të Republikës së Kosovës në shumën prej 350.00€;
 3. Për qytetarë jo-kosovar, dhe jo- anëtarë të OSK-së në shumën prej 400.00€;
 4. Për persona juridik organizata jo-profesionale të regjistruara në Republikën e Kosovës në shumën prej 150.00€
 5. Për persona juridik organizata profitabile të regjistruara në Republikën e Kosovës në shumë prej 400.00€
 6. Për persona juridik organizata ndërkombëtare që nuk janë të regjistruara në Republikën e Kosovës dhe nuk janë në mardhënie partneriteti me njësitë e qeverisë së Kosovës në shumën prej 350.00€.

- II. Organi kompetent i cili lejon hulumtimin, cakton taksën administrative varësisht nga kategoria e përcaktuar me paragrafin I të këtij neni.

VII. Zbatimi i taksave administrative

1. Taksa administrative për iniciimin e procedurës së licencimit dhe rilicencimit nuk kthehet në rast të refuzimit të licencimit apo rilicencimit.
2. Me rastin e dhënies së licencës, shuma e taksës së paguar për iniciim të procedurës do të llogaritet në totalin e taksës administrative për lëshimin e licencës së punës.

VIII. Hytja në fuqi

1. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat e mëhershme që kanë përcaktuar lartësinë e taksave administrative të Odës.
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas miratimit të tij nga Kuvendi i OSK-së.

Prishtinë, 21 dhjetor 2019



Kryetari i OSK-së

Prof. Dr. Blerim Kamberi



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

KUVENDI I ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS (OSK), në mbështetje të Nenit 19, paragrafi 1 me nën-paragrafi 1.15 të Ligjit 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Neni 20, paragrafi 1 me në-paragrafin 1.18 të Statutit të Odës së Stomatologëve të Kosovës, në nëpërmjet votimi elektronik (me e-mail) prej dt.18.02.2021 deri 19.12.2021, nxjerrë këtë:

VENDIM

PLOTËSIM/NDRYSHIM TË VENDIMIT NR. 1058 PËR CAKTIMIN E LARTËSISË SË TAKSAVE ADMINISTRATIVE NË OSK

- I. Ndryshohet pika II, nënpika 4 e vendimit nr. 1058 i datës 26.12.2019 të Kuvendit të OSK-së për përcaktimin e lartësisë së taksave administrative në OSK.
 - Taksa administrative për lëshimin e faksimilit prej 20€ ulet në shumë 15€.
- II. Pikat tjera të vendimit mbesin në fuqi.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Vendimi i dërgohet:-

- Shërbimit Profesional të OSK-së
- Arkivit

Kryetari i OSK-së

Prof.Dr. Blerim Kamberi

